



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 01.04.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2018”.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizimit në Shqipëri për vitin 2018”

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho dhe Elena Xhina.

Mungojnë:

Fatmir Xhafaj, Damian Gjiknuri dhe Tom Doshi

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kourumi është bërë për të vazhduar mbledhjen.

Në rendin e ditës kemi dy çështje:

E para, është shqyrtimi dhe miratimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2018”.

Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relator është kolegu Bashkim Fino.

E dyta, është shqyrtimi dhe miratimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri për vitin 2018”

Relator në këtë projektrezolutë do të jetë kolegu Adnor Shameti.

Zoti Fino, ju lutem, na bëni një prezantim të projektrezolutës për kolegët e komisionit dhe më pas është i hapur debati për të votuar tekstin final, për t’ia kaluar seancës plenare për votim.

Fjala për ju.

Bashkim Fino – Faleminderit, kryetar!

Siç jeni në dijeni raportin e KQZ-së e kemi diskutuar edhe ditën e seancës me kryetarin e KQZ-së, ku u bënë disa vërejtje dhe sugjerime, të cilat i kemi pasqyruar edhe në këtë projektrezolutë. Ne jemi përpjekur të bëjmë një rezolutë me gjëra konkrete, të cilat KQZ-ja duhet t’i realizojë gjatë vitit 2019, kjo edhe në kuadër të pyetjeve dhe diskutimeve që bëme javën e kaluar.

Do të jem shumë i kënaqur nëse kolegët do të kishin ndonjë sugjerim apo saktësim për ta rregulluar këtë rezolutë. Ditën e mërkurë, që është edhe seanca plenare, ku kryetari, besoj se do të jenë prezent edhe gjithë anëtarët e tjerë të KQZ-së, do të raportoj për veprimtarinë e KQZ-së për vitin 2018, ku ne do të kemi mundësi të shprehim sugjerime dhe të bëjmë diskutime, për ta bërë më të plotë miratimin e kësaj rezolute.

Për vitin 2019 KQZ-në jemi munduar ta orientojmë të miratojë manualin e raportit vjetor periodik të programit të punës së viteve në vazhdim.

Të marrë masa për garantimin dhe funksionimin e rregullt të administratës zgjedhore, duke konsideruar që mund të ndodhë në kushtet e braktisjes së sistemit nga partitë kryesore të opozitës parlamentare.

Të marrë masa, të përshtatshme dhe proporcionale, për monitorimin nga afër të kushteve dhe kriterëve ligjore për financimin publik dhe privat të fushatës zgjedhore të subjekteve dhe pjesëmarrësve në zgjedhje;

Të ngrejë mekanizmat e një monitorimi të fushatës në medie.

Të sigurojë transparencën e monitorimit të medieve.

Të reagojë në kohë dhe të kundërpërgjigjet me masa të shpejta propocionale dhe efikase të praktikave që përfshijë barazinë ligjore në fushatën mediatike.

Të përpunojë strategjinë e përshtatshme në edukimin zgjedhor, për hir të rrethanave specifike politike.

Të lehtësojë procedurat për akreditimin e vëzhguesve me qëllim rritjen e transparencës së procesit zgjedhor dhe mbulimin kapilar të tij në të gjithë Shqipërinë.

Të marrë masa të përshtatshme dhe propocionale për monitorimin nga afër të përdorimit të burimeve shtetërore dhe ndërhyrjeve në kohë reale pranë institucioneve publike për ndërmarrjen dhe korrigjimin e praktikave të kundërligjshme në këtë drejtim.

Të hartojë metodologjinë e kontrollit të verifikimit, kjo është shumë e rëndësishme, të shpenzimeve të partive politike dhe fushatave elektorale brenda dhe jashtë vendit, duke shqyrtuar edhe mundësinë e lidhjes së marrëveshjes së bashkëpunimit me autoritetet përgjegjëse, që kontrollojnë pastrimin e parave dhe financimet e kundërligjshme.

Të përmirësojë shqyrtimin administrativ të verifikimit të financimit të fushatës zgjedhore, jo vetëm mbi bazën e deklarimit të subjekteve zgjedhore të partive politike, por edhe mbi bazën e dokumenteve dhe fakteve të deklaruarra e të bëra publike, duke iu referuar eksperiencës së vitit 2018, që është një rast për t'u trajtuar.

Në rastet e masave ndëshkimore me gjobë ndaj subjekteve zgjedhore, ne sugjerojmë që për shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor të nisin menjëherë procedurat për mbledhjen e të gjitha detyrimeve financiare, gjë që ishte e mangët gjatë vitit 2018.

Gjithashtu, të synojë një sjellje institucionale, për sa i takon vendimmarrjes në funksion të ruajtjes së pavarësisë dhe referimit të dispozitave ligjore, në plotësim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emëron ose ushtron funksione publike” dhe të sigurojë në të ardhmen një interpretim dhe zbatim të paanshëm në të njëjtin ligj.

Në funksion të transparencës dhe sigurimit të aksesit të informacionit për publikun, faqja zyrtare e KQZ-së ta jetë më e aksesueshme nga publiku dhe jo vetëm nga ata që e njohin më në thellësi këtë çështje.

Të miratojë rregullat e përfaqësimit publik të institucionit në daljet publike të anëtarëve të KQZ-së. Anëtarët e KQZ-së janë një organ vendimmarrës dhe kolegjal dhe nuk u takon shprehja e mendimit personal jashtë tryezës së mbledhjes së KQZ-së. Pra, vendimmarrja në KQZ është një verdikt i gjithë komisionit dhe çdo anëtar i KQZ-së ka të drejtë të trajtojë në pakicë mendimin e tij në këtë vendimmarrje, por kjo nuk do të thotë që duhet të dalin në publik apo televizione të ndryshme dhe të shprehin mendimin e tyre personal në kundërshti me vendimmarrjen që merr KQZ-ja.

Këto ishin pak a shumë pikat kryesore të kësaj projektrezolutive, të cilat janë në funksion të asaj që dëgjuam në relacionin e raportit, me vërejtjet, sugjerimet dhe diskutimet që bëmë javën e kaluar.

Gjithsesi, deputetët janë të mirëpritur për vërejtjet dhe sugjerimet që kanë dhe jemi gati të rregullojmë ndonjë gjë konkrete.

Për sa u përket afateve dhe kohës, që unë e kam kërkuar edhe për rezoluta të tjera, ka të bëjë me gjithë vitin ushtrimor. Një pjesë e tyre është brenda 6-mujorit të parë, sepse gjobat dhe financimet e partive kanë të bëjnë me zgjedhjet e 30 qershorit dhe menjëherë mbas tyre do të ketë vendime përkatëse, prandaj jam munduar ta trajtoj në këtë mënyrë këtë projektrezolutë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

A ka sugjerime apo komente nga kolegët në lidhje me projektrezolutën?

Fjalën e ka zoti Shameti.

Adnor Shameti – Faleminderit, zoti kryetar!

Së pari, dua të shpreh vlerësimin për draftin e paraqitur nga relatori, zoti Fino, për veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili është një institucion shumë i rëndësishëm, aq më tepër edhe për të gjithë pretendimet dhe tymnajat e ngritura deri më tani për procesin zgjedhor. Zoti Fino në hartimin e kësaj projektrezolutive ka qenë shterues dhe shumë kreativ, pasi ndihet dora e tij, ku del jashtë kornizave të stereotipave të krijuara deri më tani në projektrezolutat e kaluara. Në këto kushte ftoj kolegët që ta miratojmë këtë projektrezolutë njëzëri.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Shameti!

Fjalën e ka zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti kryetar!

Duke qenë në frymën dhe në filozofinë e shprehur vijimësi nga kolegu Fino, në lidhje me rezolutat, vazhdoj të jem konseguent në atë që shpreha në mbledhjen e kaluar për problematikën e theksuar, në gjykimin tim, që ka pasur lidhur me kontrollin e financave të partive politike dhe një mungesë totale të vendimmarrjes të KQZ-së në disa raste.

Me “mungesë totale” nënkuptoj faktin që KQZ-ja ka qenë e paaftë të marrë vendime për këto raste. Unë mendoj që nuk mundet të shmanget futja në rezolutë e këtij problemi në mënyrë taksative. Në fakt, është e përfshirë nëse e shikojmë në kërkesën që Kuvendi i ngarkon KQZ-së, ku thuhet: “Të hartojë metodologjinë e kontrollit dhe të tjera”, por kjo është në kuadrin teorik. Unë mendoj që të përcaktohet në pjesën e parë të projektrezolutës, aty ku themi: “Nisur nga problematikat e hasura...”, një nga problematikat duhet cituar. Pra, të futet aty ku thuhet: “Problematikat lidhur me kontrollin e financimit të partive dhe mangësitë e vendimmarrjes së KQZ-së për këtë çështje...” dhe të jetë më e theksuar te kërkesa që Kuvendi u bën partive politike. Këtë e them, sepse këtu u pranua që KQZ-ja ishte e paaftë të merrte vendim për një rast të njohur botërisht, për rastin e një partie politike dhe liderit të saj të kapur duke financuar gati 1 milion dollarë me para të panjohura, pra kemi hajdutin me “presh në dorë”. Në këto kushte unë mendoj që rezoluta nuk mund të përkëdhelë më institucionin që ka për detyrë të bëjë transparencën e financimit të tyre, por duhet t’u tërheqë vëmendjen që nuk e kanë bërë fare detyrën gjatë vitit të kaluar dhe t’ia ngarkojë për këtë vit.

Shpresoj në mirëkuptimin e relatorit dhe të kolegëve!

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Zonja Hysi, urdhëroni!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit edhe për përmbajtjen e kësaj rezolute, e cila është shumë konkrete dhe adreson një sërë shqetësimesh!

Zoti Fino, unë kam një sugjerim për paragrafin e fundit, ku ju me të drejtë kërkon të miratohen rregullat e përfaqësimit publik të institucioneve dhe daljet publike. Mendoj se fjalia e dytë është e tepërt, sepse nuk mund të hyjmë në detaje e të themi se çdo anëtar i zgjedhur i KQZ-së flet në mbledhje dhe arsyetimi i tij është pjesë e vendimmarrjes, por është e mjaftueshme të miratohen rregullat e përfaqësimit publik dhe të daljeve së anëtarëve në përputhje me manualin e monitorimit vjetor.

Gjithashtu, kam një sugjerim. Ne jemi në një vit zgjedhor dhe kjo gjë ka rëndësi. Ndërkohë, kemi miratuar një ligj për pakicat kombëtare në Shqipëri. Komisioni Qendror i

Zgjedhjeve ka detyrimin të krijojë akses për të mundësuar sensibilizim, edukim ligjor, por edhe një pjesëmarrje sa më të madhe të minoriteteve. Unë do të sugjeroj që, nëse është e mundur, të shtojmë një pikë, që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të fokusohet në rritjen e informimit dhe sensibilizimit të pakicave kombëtare në territoret ku ata banojnë. E them këtë, sepse KQZ-ja është në avantgardë, ka nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të ligjit për pakicat kombëtare dhe në këtë kuadër mund të bëjmë edhe një monitorim dhe, vitin tjetër, kur të raportojmë, mund të marrim edhe një tregues të ecurisë së zbatimit të këtij ligji.

Për pjesën tjetër nuk kam çfarë të them, sepse është shumë konkrete, në përputhje edhe me rekomandimet e ODIHR-it dhe me nevojat që kemi ne për të pasur zgjedhje me standarde.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, kolegëve, për ndihmesën që dhanë!

Po e nis nga zoti Hyseni. Më lejoni t'ju them se ka plotësisht të drejtë kur thotë se problematika e shtruar gjatë vitit 2018 duhet të trajtohet në fillim si në preambul të hapjes, por ne në rezolutë e kemi theksuar shumë qartë dhe shumë drejtë këtë çështje. Jam dakord që financimi i partive politike të vihet në pjesën e parë si një nga problematikat që ka ndodhur gjatë vitit 2018, por në projektrezolutë është shprehur qartë kur themi: “jo vetëm mbi bazat e deklaratave të subjekteve zgjedhore”, pra të partive që bëjnë deklarata sa janë fondet për fushatë, por mbi bazën e dokumenteve dhe fakteve të deklaruara apo të bëra publike duke referuar eksperiencën e vitit 2018. Çfarë dua të them me këtë? Për gjithë këtë që ka ndodhur, që prokuroria ka hapur një çështje për financimin e zgjedhjeve dhe subjekteve zgjedhore, në projektrezolutë mund të themi se për shkak të eksperiencës së vitit 2018 që jo vetëm mbi bazën e deklaratave dhe subjekteve, por mbi bazën e dokumenteve dhe fakteve të deklaruara, që KQZ-ja ka për detyrë të deklarojë. Më hapur se kaq nuk mund të trajtohet. Gjithsesi, ne mund ta trajtojmë në pjesën e parë të problematikës.

Për sa u përket dy sugjerimeve të zonjës Hysi, jam dakord me sugjerimin e dytë. Atje mund të vihet një pikë për pakicën kombëtare, për të qenë në koherencë të plotë me raportin e OSBE-ODIHR-it, edhe pse jam i bindur që pakicat kombëtare janë shumë të interesuara për zgjedhjet, sidomos vendore. Jo pa qëllim, në ndarjen territoriale që kemi bërë në Shqipëri, i kemi lënë 3 bashki jo në funksion të të gjitha kriterëve që kemi ndjekur për bashkitë e tjera. Unë kam qenë iniciuesi i kësaj ndarjeje, dhe bashkitë e tjera kanë një sipërfaqe të madhe, një aktivitet dhe popullsi më të madhe, ndërkohë që tri bashkitë e tjera, Pushtecin, Dropullin dhe

Konispolin, i kemi lënë në funksion të pakicave kombëtare, që ato të ndihen mirë, sidomos në zgjedhjet vendore. Mund ta trajtojmë si një çështje, por ata e kanë parasysh.

Për çështjen e parë të zonjës Hysi mendoj se nuk ka asgjë të tepërt fjalë e dytë. Këtë gjë e gjykojmë bashkërisht dhe nuk ka problem edhe nëse hiqet, sepse ajo çfarë dua të them unë është trajtuar te pika e parë kur them “të miratojmë rregulloren e përfaqësimit publik të institucionit, të daljeve në publik të anëtarëve të KQZ-së”, por fakti që ne e vëmë me forcë diçka të tillë... Ne po bëjmë një projektrezolutë të detajuar. Në komision kam kërkuar gjithmonë që projektrezolutat të jenë super të detajuara, që të kërkojmë llogari te raporti i vitit 2019. Nuk ka asgjë të keqe nëse themi se anëtarët e KQZ-së duhet të evitojnë shprehjet e mendimit personal jashtë mbledhjes së KQZ-së, sepse kur e ke në rezolutë dhe e ka votuar edhe parlamenti, është publike për të gjithë anëtarët e KQZ-së, të cilëve u thuhet: “Ju, zotërinj, jeni një organ vendimmarrjeje kolegjal, keni një manual monitorimi vjetor periodik të miratuar, por keni edhe rregullat e përfaqësimit publik të institucionit dhe kjo nuk ju lejon ju të shkoni dhe të bëni” ... Një anëtar KQZ-je për mua është 24 orë anëtar, nga momenti që merr mandatin, deri në momentin që e dorëzon mandatin. Një anëtar KQZ-je nuk mund të jetë nga ora 8:00 deri në 16:00, kur mbaron orari i punës, dhe pas asaj të jetë jurist i shquar, që do të flasësh për çdo gjë dhe madje flet edhe për KQZ-në, kur je vendimmarrës dhe ke votuar atje. Besoj se nuk është e tepërt. Gjithsesi nuk më krijon asnjë merak nëse hiqet fjalë e dytë. Në fjalinë e dytë u themi atyre: kujdes, sepse ju duhet të mbronin një vendimmarrje kur e merrni vendimin dhe nuk mund të mbronin vendimin e pakicës. Vendimi i pakicës është i shkruar në vendim kur del vendimi i KQZ-së.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Përpara se të votojmë, dua të jap një mendim për projektrezolutën.

E para, dua të falënderoj kolegun Fino, por edhe të gjithë kolegët që u përfshinë në diskutimin kësaj projektrezolute!

Për këshilltarët dua të them se në pjesën e parë duhet të fiksohet, problematikë e ngritur edhe nga zoti Fino në tekstet e tjera të projektrezolutave, ku thuhet: “Kuvendi i Shqipërisë për sa më sipër”, duke konsideruar edhe faktin që viti në vazhdim është vit zgjedhor, përveç mbështetjes institucionale, që i duhet ofruar në vijim Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për të kryer detyrat sipas Kodit Zgjedhor kërkon edhe angazhimin e komisionit në këtë drejtime. Pra, përpos detyrave që i ngarkon Kodi Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të fokusohet edhe në këto drejtime kryesore që prezantoi kolegu Fino.

Së dyti, jam shumë dakord që pika 8, e cila flet për kontrollin dhe verifikimin e shpenzimeve financiare të partive politike gjatë fushatave elektorale, të ripozicionohet në tekstin e rezolutës. Është shumë e rëndësishme për opinionin publik dhe mediet që kjo pikë e kësaj rezolute të evidentohet si risi.

Çfarë thotë kjo pikë? Së pari, i kërkon KQZ-së të hartojë një metodologji kontrolli dhe verifikimi të shpenzimeve të financimeve të partive politike dhe të fushatave elektorale. Kjo përfshin kontrollin dhe verifikimin brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Së dyti, i kërkon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që brenda hapësirave që lejon ligji të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me autoritetet përgjegjëse që kontrollojnë pastrimin e parave dhe financimet e kundërligjshme në nivel kombëtar, por, nëse e lejon ligji, edhe në nivel ndërkombëtar.

Së treti, jo më pak e rëndësishme, metodologjia e kontrollit dhe verifikimit të mos përfshijë më vetëm deklaratimet që bëjnë vetë subjektet, por KQZ-ja të ketë një rol aktiv në hetimin administrativ kur ka dyshime për financimin e partive politike dhe të fushatave elektorale. Mua më vjen mirë që është reflektuar në tekstin e kësaj projektrezolute, ndryshe nga rezolutat e tjera. Flasim nga mëngjesi deri në darkë për zgjedhjet, për financimet e paligjshme gjatë fushatave elektorale, por në fund të ditës ai që i adreson siç duhet këto shqetësime është ligji, ndaj kjo rezolute vjen në frymën e Kodit Zgjedhor dhe të ligjit.

Siç e tha edhe zoti Fino, jam dakord që të fokusohet në një pjesë të projektrezolutës edhe sensibilizimi i pakicave kombëtare gjatë fushatës elektorale dhe, pse jo, vitin që vjen të kemi një tregues të këtij aspekti të zbatimit të Kodit Zgjedhor nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për pakicat. Jemi ndër shtetet e pakta që kemi një kuadër ligjor bashkëkohor për sa u përket pakicave kombëtare. Ndoshta jemi ndër vendet e pakta, kuvendi i të cilit miratoi një ligj të posaçëm për pakicat kombëtare.

Shumë faleminderit të gjithë kolegëve, në veçanti zotit Fino, këshilltarëve, stafit të punonjësve të Kuvendit dhe Shërbimit të Monitorimit të Institucioneve të Pavarura për angazhimin në hartimin e kësaj projektrezolute, të rezolutave të tjera që ne kemi miratuar në ditët e kaluara, por edhe të asaj që do të miratojmë pas kësaj!

Kush është dakord me tekstin e kësaj projektrezolute, me ato sugjerime që bënë kolegët për reflektim? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Rezoluta së bashku me raportin përkatës t'i kalojnë seancës plenare për votim ditën e mërkurë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 01.04.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi dhe miratimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri për vitin 2018”

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho dhe Elena Xhina.

Mungojnë:

Fatmir Xhafaj, Damian Gjikhuri dhe Tom Doshi

Ulsi Manja - Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës, shqyrtimi dhe miratimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri për vitin 2018”. Ne jemi komision përgjegjës.

Fjalën e ka kolegu Adnor Shameti për të bërë një prezantim të shkurtër të kësaj projektrezolute dhe pastaj vazhdojmë me diskutimet.

Adnor Shameti – Faleminderit, zoti kryetar!

Pasi realizuam seancën dëgjimore me drejtuesit e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri për vitin 2018, ju kemi paraqitur një projektrezolutë, e cila është shpërndarë në të gjithë anëtarët e komisionit.

Projektrezoluta përfshin të gjitha gjetjet që dolën nga seanca dëgjimore me drejtuesit e Institutit. Në thelb pasqyron veprimtarinë e lavdërueshme të Institutit për vitin që shkoi, sikurse jep edhe rekomandimet përkatëse, të cilat i kemi pasqyruar edhe në relacionin përkatës gjatë seancës dëgjimore.

Është e rëndësishme që, sikurse e paraqita edhe në seancën dëgjimore me drejtuesit e Institutit, nga ana e Kuvendit dhe Komisionit të Ligjeve të realizohen të gjitha kërkesat legjitime të paraqitura nga drejtuesit e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit dhe nga tjetër të evidentohen dhe gjejnë pasqyrim të gjitha rekomandimet e Komisionit të Ligjeve për veprimtarinë në vitin në vijim. Pra, nga njëra anë të plotësohet organika dhe realizimi i kushteve më të mira për ambientet dhe gjithë të tjerat, që u kërkuar nga përfaqësuesit e Institutit, dhe nga ana tjetër të gjejnë pasqyrim dhe evidentohen të gjitha gjetjet e Komisionit të Ligjeve dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për veprimtarinë në vitin në vijim.

Duke mos dashur të bie në përsëritje dhe t’ju marr më shumë kohë për projektrezolutën, pasi draftin e keni të gjithë, ju ftoj të gjithëve ta miratojmë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Shameti!

Ka sugjerime nga kolegët për tekstin e projektrezolutës?

Fjalën e ka zoti Braho dhe pastaj zonja Hysi.

Spartak Braho – Nuk jam dakord me përfundimin e relatorit që puna që ky institut ka bërë është e lavdërueshme.

Ky institut, me Agron Tufën në krye, është kthyer në një seksion të Partisë së Ballit Kombëtar. Ka marrë përsipër të nxijë çdo gjë, duke përfshirë luftën, heronjtë, dëshmorët dhe nuk ka asgjë shkencore në të gjitha analizat që ka bërë. Ky është thjesht një institut studimi që nuk ka pse të ngatërrohet me politikën, nuk ka pse operon me terminologji lustracioni, sepse

lustracioni është ndaluar me ligjin që kemi miratuar, në veprimtarinë e të cilit ka shumë helm. Në këto kushte unë nuk do të votoj pro kësaj rezolutë, madje do të kërkoj shkarkimin e Agron Tufës deri kur ai t'i thërrasë mendjes dhe të jetë më i ekuilibruar në të gjithë veprimtarinë tij.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Braho!

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Po lexoj pjesën e parë të rezolutës për veprimtarinë e këtij instituti në vitin 2018 me rekomandimet për vitin 2019. Në dijeninë time, vjet ne i kemi kërkuar Institutit të jetë sa më shkencor, objektiv dhe realist. Funksioni i këtij instituti është të mbledhë fakte, të cilat mund të zhduken me kalimin e kohës.

Le t'i marrim një për një rekomandimet që kemi bërë. Për rekomandimin e parë nuk kam gjë.

Në rekomandimin e dytë, ku thuhet “të vijojë publikimin e të gjithë veprimtarive që kanë çuar në dhunimin e të drejtave të njeriut”, nuk jemi realistë. Një institut me ata njerëz, që nuk janë kërkues shkencorë, nuk mund të bëjë publikimin e të gjithë veprimtarisë, ndaj sugjeroj të themi: “të vijojë publikimin e veprimtarive që kanë çuar në shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në vitet e regjimit komunist”. Të mbyllet këtu, sepse brenda ka shumë gjuhë që e paragjykon punën dhe e pozicionon Kuvendin.

Për sa i përket rekomandimit të tretë, sugjeroj të riformulohet, të jetë më neutral dhe të thuhet: “Të studiojë mekanizmat që u përdorën nga organet shtetërore dhe partiake për të krijuar hendekun ndërmjet kundërshtarëve politikë realë ose potencialë me pjesën tjetër të popullsisë”. Armiku i popullit, roli i organizatave e të tjera, nuk besoj se një institucion mund t'i bëjë për gjashtë muaj.

Për sa i përket rekomandimit të pestë, unë mendoj se kjo nuk mund të bëhet. “Të evidentojë dhe pasqyrojë ndryshimet që solli diktatura komuniste në planin social dhe mendjet e njerëzve”. Kjo është shumë e përgjithshme, ndaj mendoj që ky rekomandim duhet hequr. Njëkohësisht, duhet hequr edhe rekomandimi 6: “Të kontribuojë në rehabilitimin dhe në integrimin e plotë dhe dinjitoz të viktimave të sistemit komunist”.

Të dashur kolegë,

Viktimat e sistemit komunist nuk mund t'i rehabilitojë dhe t'i integrojë një institut studimi. Kjo është detyrë e institucioneve shtetërore, e organeve të qeverisjes vendore. Ata kanë shumë nevojë të rehabilitohen, por pas 27 vjetësh këtë nuk mund ta bëjë instituti, i cili studion, evidenton dhe sjell fakte. Në këtë rezolutë mungon problematika që ka dalë midis Autoritetit të Hapjes së Dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit me këtë institut.

Duhet të jetë një pikë që ka qenë edhe në rezolutën e vitit të kaluar, ku thuhej: “Forcimi i bashkëpunimit mes organizmave vendase dhe ndërkombëtare pasi shumë të dhëna janë në arkiva të vendeve të tjera. Unë mendoj se edhe në këtë vit të themi, që të vazhdojë bashkëpunimin me institucionet.

Lidhur me pikat e tjera, mund të qëndrojnë, por unë mendoj se ne nuk mund ta fetishizojmë dhe t’i japim këtë rol kaq të madh që nuk e ka as Akademia e Shkencave dhe nuk e bëjnë dot as studiuesit. Të thuash: të evidentosh rolin që luan media dhe gazetaria e vendit postkomuniste, ne i bëjmë këta gazetarë, politikanë, artistë, vlerësues të organizatave të masave. Pra, është shumë e vështirë. Prandaj, duhet të jemi pak më konkretë. Këtu kam sugjerim për ta ditur dhe për ta vlerësuar punën e këtij institucioni, për të pasur tregues konkretë dhe të matshëm.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Urdhëroni, zoti Shameti!

Adnor Shameti – Faleminderit, zoti kryetar!

Dua të shpreh mirëkuptimin e plotë për të gjitha gjetjet e zonjës Hysi në draftin e paraqitur për miratim në Komisionin e Ligjeve.

Do të kërkoja që në variantin përfundimtar të pasqyrohen të gjitha gjetjet e rekomanduara nga zonja Hysi, pasi i shoh me vend dhe mendoj se e bëjnë më të plotë draftin përfundimtar të kësaj projektrezolute. Për të gjitha gjetjet individuale të zotit Braho, nuk dua të bëj asnjë koment, por mendoj të mos pasqyrohen në draftin përfundimtar të kësaj rezolute.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Shameti!

Urdhëroni, zoti Fino!

Bashkim Fino – Duke dashur të jap një dorë në përmirësimin e kësaj projektrezolute dhe duke qenë plotësisht dakord me rekomandimet e të dy kolegëve të nderuar parafolës, qoftë të zonjës Hysi, qoftë të relatorit, unë jam dakord që të dyja këto deklarata janë të përgjithshme dhe nuk mund të vendosen këtu. Ndoshta, duhet vendosur çështja e bashkëpunimit me institucionet e tjera të vendit me ato të vendeve të tjera. Unë mendoj se duhet vendosur këtu. Më lejoni të them se do të ishte mirë që në këtë projektrezolutë të vendosnim edhe një nga çështjet që ne trajtuam para disa ditësh mbi strukturën organizative të zgjedhjes së institucioneve. Duke e vendosur në projektrezolutë, kjo do të thotë që na jep të drejtën ne që relatori në rastin konkret, të marrë përsipër të bëjë një ndryshim në ligjin

përkatës, sepse të gjitha institucionet që ne kemi krijuar me ligj janë krijuar dhe struktura organizative miratohet nga parlamenti, jo nga qeveria.

Këtu është bërë një gabim teknik, mbase jo me qëllim, që të vetmen strukturë e kemi lënë të krijohet nga qeveria ndërkohë që ky është një institut i krijuar nga ne, që raporton tek ne dhe realisht duhet të trajtohet nga ne. Duhet të bashkëpunojmë me DAP-in dhe me Ministrinë e Financave për çështjen e pagave dhe për të tjerat, sepse ajo është çështje e buxhetit të shtetit. Duke vendosur këtu në një nga pikat që për strukturën organike të këtij instituti të veprohet si me të gjitha organet e tjera të krijuara me ligj, është më se e domosdoshme, sepse kjo na mundëson që të miratojmë strukturën mbi bazën e numrit që kanë ata.

Për sa i përket pjesës së numrit të kontrollit parlamentar, unë mund të bashkohem me zotin Braho vetëm për pjesën që ka të bëjë me kontrollin parlamentar, sepse nëse ne do të kishim bërë një kontroll më të imët parlamentar për të gjitha institucionet edhe për këtë institut, të jemi të bindur që mbase nuk do të kishim këtë deklaratë të fortë të zotit Braho, por do të kishim mundësi ta korrigjonim gjatë vitit të gjithë problematikën që mund të kishte, sepse edhe relatori, edhe zonja Hysi e shprehu që ky është një institut studimor, i krijuar me shumë dashamirësi nga kjo maxhorancë, nga parlamenti ynë, që të kemi një institut për të bërë studime për çështjen e komunizmit. Me këtë nuk merret përsipër asgjë në fund të fundit dhe ne ia kemi dhënë të gjithë hapësirën, por fakti që ne nuk e kemi bërë sa dhe si duhet punën në sensin e kontrollit parlamentar, do të ishte më mirë kur të vinte puna për të parë pjesën e brendisë së të gjitha materialeve, që ata trajtojnë si institut, që do të jenë materiale edhe për ne, edhe për publikun, edhe për vendet e tjera partnere.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Urdhëroni, zoti Shameti!

Adnor Shameti – Faleminderit, zoti kryetar!

Sërish, dua të shpreh vlerësimin më të madh për gjetjet e zotit Fino dhe u bashkohem të gjithave. Sa për sqarim, sikurse u përpoqa edhe në fillim të fjalës sime sot, sikurse edhe në seancën dëgjimore me përfaqësuesit e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, ne tashmë e kemi bërë gati draftin. Unë do ta ushtroj nismën ligjore. Shumë shpejt do ta sjellim në komision me iniciativën time për të bërë plotësimin e balancës që është krijuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pa diskutim. Unë e përmenda dhe sërish dua t'ju informoj që propozimi është bërë gati për të bërë plotësimin e të gjitha mungesave, pasi kjo do të ndikojë dukshëm edhe në performancën e veprimtarisë së këtij instituti.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Shameti!

Nuk besoj se ka sugjerime të tjera nga kolegët.

Ka sugjerime të tjera? Nuk ka.

Edhe unë jam plotësisht dakord me sugjerimet e koleges Hysi, që ky institut, sipas ligjit, është një institut studimesh dhe ka një mision kryesor: nxjerrjen në dritë të fakteve historike që mund të zhduken dhe t'i bëhen të ditura opinionit publik për një periudhë kohore të historisë sonë, e cila duhet ndriçuar siç duhet. Pra, flitet për periudhën e regjimit komunist, që kurrësi nuk duhet të ngatërrohet me luftën, siç e tha edhe kolegu Braho, sepse lufta është tjetër gjë dhe periudha e regjimit komunist është një gjë krejtësisht tjetër.

Do t'u kërkoja edhe relatorit edhe këshilltarëve, edhe stafit që është marrë me hartimin e kësaj projektrezolute që në linjë të asaj që tha kolegja Hysi, nga teksti i projektrezolutës të hiqen ato pjesë të rekomandimeve ose të riformulohen ato që t'i japin kreativitet punës së këtij instituti. Çfarë duhet të them me këtë?

Shoh një pikë të rezolutës, ku thuhet: “Të evidentohet roli që media dhe gazetaria shqiptare kanë luajtur gjatë periudhës postkomuniste.” Kur përdoren fjalët “kanë luajtur”, i jep të drejtën këtij instituti të bëjë punë krijuese. Mund të thuhej: “Të evidentohet roli që media dhe gazetaria shqiptare ka pasur gjatë kësaj periudhe”. Të mblidhen, të merren dokumentet dhe të nxirret në dritë se cili është roli i medias dhe i gazetarisë referuar këtyre fakteve historike, që gjenden në arkivat tona gjatë kësaj periudhe, por jo të bëjë përgjithësime dhe analiza krahasimor, se del jashtë misionit të këtij instituti. Kjo duhet parë në të gjitha paragrafët e kësaj projektrezolute. Unë besoj se është e mundur, sepse është një rezolutë në detyrat që lë Kuvendi për këtë institut, edhe kjo rezolutë vjen ndryshe nga të tjerat, është punuar ndryshe dhe ka kreativitet në mënyrën e formulimit dhe të hartimit nga pikëpamja e teknikës ligjore të kërkesave që ka projektrezoluta. Gjithsesi, do të duhet të shihet edhe në këtë këndvështrim, që sugjeruan kolegja Hysi, zoti Fino, zoti Braho, por edhe relatori që u tregua dashamirës për t'i reflektuar këto sugjerime në tekst.

E hedhim në votim!

Kush është dakord me këtë tekst të projektrezolutës, me ndryshimet dhe me sugjerimet që u bënë nga kolegët?

Pro?

Kundër? Vetëm zoti Braho është kundër.

Abstenim? Nuk ka.

Një votë kundër. Miratohet.

Edhe kjo projektrezolutë së bashku me raportin përkatës, duke marrë në konsideratë sugjerimet që u bënë këtu për ato që thanë kolegët, të bëhet gati për t'u votuar për seancën plenare të ditës së mërkurë.

E mbyllim këtu mbledhjen e sotme.

Shumë faleminderit!

Ju uroj një ditë dhe një muaj të mbarë!

Faleminderit!